

Të lexosh me fëmijën

0-12 muaj



booktrust.org.uk

 **BookTrust**
Getting children reading

Është argëtuese t'i lexosh një libër fëmijës – janë çaste për t'u lidhur, për të qeshur e për të biseduar së bashku.

Kur lexon me fëmijën, e ndihmon të zhvillohet, forcon lidhjen që ke dhe e përgatit për shkollën.

Të dashur nëna, baballarë dhe kujdestarë,

Nuk është kurrë vonë të filloni të lexoni libra së bashku. Kur i lexon fëmijës që në moshë të vogël, e ndihmon ta fillojë sa më mirë jetën.

Por jo të gjithë kanë vetëbesimin që u duhet për të lexuar librat me zë, ndaj kjo broshurë është plot me sugjerime dhe ide se si të nxirrni sa më shumë dobi duke lexuar libra së bashku.

**Nga:
Të gjithë ne në BookTrust**



Këshillat më të mira për të lexuar së bashku

- Gjej një vend të qetë, pa zhurma, pa televizion dhe pa telefon.
- Merr kohë që të shohësh dhe të flasësh për figurat.
- Nuk ka rëndësi nëse fëmija fillon t'i kafshojë librat. Shumë shpejt do të ketë qejf të të ndihmojë të kthesh faqet!



- **Përdor zhurmat e kafshëve ose tinguj – këto ndihmojnë për t'i dhënë jetë tregimit dhe ju sjellin të qeshura!**
- **Tregimet dhe recitimet mund të shijohen me të gjithë familjen, ndaj pse të mos ftosh edhe pjesëtarët e tjerë të familjes?**
- **Nuk ka rëndësi je apo nuk je lexues i mirë – fëmija kënaqet edhe vetëm kur dëgjon zërin tënd.**



Koha e recitimit

Argëtohuni duke kënduar këtë vjershë me fëmijën:

Yll i vogël, yll i vogël,

Sa çudi më bën kush je!

Lart mbi botë në qiell rri,

Si diamant që shndrit mbi ne.

Yll i vogël, yll i vogël,

Sa çudi më bën kush je!



- **Yll i vogël, yll i vogël' është një rimë shumë e bukur për gjumë – pse të mos shihni së bashku qiellin me yje natën?**
- **Bëj yje me duar – hapi dhe mbylli duart për të treguar yllin që shndrit.**
- **Kur recitoni së bashku, qoftë edhe për pak minuta, mund ta ndihmosh fëmijën të bëhet lexues i mirë.**

Pse është e rëndësishme t'i lexosh fëmijës

- Leximi së bashku ju ndihmon të krijoni një lidhje të fortë e të dashur me fëmijën.
- Nëse e bëni zakon të lexoni tregime e të recitoni, kjo e ndihmon fëmijën të komunikojë dhe ndikon në shëndetin e mirë të tij.
- Fëmijët që lexojnë që në moshë të njomë bëhen më të zotë në shkollë – recitimi dhe leximi i tregimeve së bashku i ndihmon ta fillojnë jetën mbarë!



Le të zgjedhim disa libra

Nuk është problem të lexosh vazhdimisht të njëjtin libër, sepse fëmija ngushëllohet dhe krijon besim me librat që i njeh tashmë.

Dhe nëse jeni gati për të bërë një ndryshim, përdor Bookfinder tonë për të kërkuar libra lidhur me gjërat që fëmija i ka qejf. Mund të gjesh ide për fëmijët e të gjitha moshave, nga foshnjat deri tek adoleshentët.

booktrust.org.uk/books

Në faqen vijuese gjenden disa ide për libra të rinj fantastikë për të filluar.



Disa libra fantastikë për të filluar



Është një fëmijë i vogël

Julia Donaldson, ilustruar nga Rebecca Cobb (Macmillan Children's Books)

Dikush po fshihet në çdo faqe të këtij libri të bukur e të thjeshtë – pas grumbullit të rrobave për t'u larë, në barin e gjatë që valëvitet nga era dhe pas koleksionit të arushëve prej pelushi. Ngri kapakun për të gjetur fëmijën e për të parë se ç'po bën!



Ora e gjumit për vogëlushin Sparkle

(DK Children's)

Dil nga banja, vish kostumin e gjumit njëlloj si Tedi i lodhur dhe lexo këtë tregim të bukur para gjumit. Një libër i thjeshtë me fletë të trasha plot me foto shumëngjyrëshe dhe faqe me xixa që fëmija do të ketë qejf t'i prekë.




Unë...

Emma Dodd

(Templar Publishing)

Një pinguin i vogël kupton sa i vogël është kur sheh sa të larta janë malet dhe sa i thellë është oceani... por për prindin e tij ai është vërtet shumë i madh! Një libër me ilustrime të bukura për ta përqafuar.



Ku është zoti Qen?

Ingela P Arrhenius

(Nosy Crow)

A mund t'i gjesh të gjitha kafshët miqësore që ndodhen pas kapakëve në këtë libër plot drita dhe hare? Ka edhe një pasqyrë në faqen e fundit për të parë një fytyrë që e do shumë!

A të duhen më shumë ide?

- Shko te biblioteka pranë për të marrë hua libra falas. Shiko nëse organizojnë sesione “Ora e recitimit” ose “Ora e tregimeve”, ku mund të takohesh me familje të tjera dhe të shijoni recitimet së bashku!
- Pyet konsultoren e fëmijëve për ide se si mund ta ndihmosh zhvillimin e foshnjës duke lexuar libra së bashku.
- Gjej libra fantastikë në internet me Book-Trust! Në faqen tonë të internetit ka plot ide për libra, si edhe shumë këshilla se si ta bëni leximin argëtues. booktrust.org.uk





BookTrust është organizata bamirëse më e madhe në MB e leximit për fëmijë. Ne jemi të përkushtuar t'i ndihmojmë fëmijët të lexojnë.

Illustrimet nga Daniel Taylor

Numri i organizatës bamirëse: 313343

Na ndiqni  |  |  |  | 

booktrust.org.uk

 **BookTrust**
Getting children reading